

Nr. .... Prot  
*Lutemi referoni këtë numër në përgjigje*

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2022

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Drejtuar:** Bashkimit të operatorëve ekonomik “Iliriada” sh.p.k, NIPT J61828125L, & “Divitech” sh.p.k, NIPT L01306049O, me adresë: Tiranë, Rruga Sali Butka, pallati TBM Construction, Shkalla 2, Kati 3, Ap.11.

**Procedura e prokurimit/lotit:** Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar- mallra.

**Numri i procedurës / referenca e Lotit:** NR.REF-34473-06-27-2022.

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** “Përditësimi i versionit të software të sistemit SCALA 250, sistemit operativ dhe hardware për DCS SCADA në HEC Koman”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 15 (pesëmbëdhjetë) muaj.

**Publikimet e mëparshme:** Buletini i Njoftimeve Publike Nr.90, datë 04/07/2022.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** Oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1-** Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Iliriada” sh.p.k, NIPT J61828125L, & “Divitech” sh.p.k NIPT L01306049O, me ofertë ekonomike 223,500,000 (Dyqind e njëzet e tre milionë e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH.
- 2-** Operatori Ekonomik “ATOM” sh.p.k, NIPT L22203042N, me ofertë ekonomike 223,723,805 (Dyqind e njëzet e tre milionë e shtatëqind e njëzet e tre mijë e tetëqind e pesë) Lekë pa TVSH.
- 3-** Operatori Ekonomik “INFOSOFT SYSTEMS” sh.p.k NIPT J61820021C, me ofertë ekonomike 223,900,000 (Dyqind e njëzet e tre milionë e nëntëqind mijë) Lekë pa TVSH.
- 4-** Operatori Ekonomik “IT.Net” sh.p.k, NIPT L92606403F, me ofertë ekonomike 225,984,600 (Dyqind e njëzet e pesë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- 1-** Operatori Ekonomik “ATOM” sh.p.k, NIPT L22203042N, pasi:

- ✚ Nuk plotëson pikën 2.3.1 kapaciteti teknik, në lidhje me vlerën e kërkuar për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.3 kapaciteti teknik në DT, pasi nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, kërkesë e kriterëve për kualifikim.
- ✚ Nuk plotëson pikën 2.3.5 kapaciteti teknik në DT pasi në Shtojca 8 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” pasi nuk ka të pasqyruar punonjësit e kërkuar sipas këtij kriteri.

## 2- Operatori Ekonomik “IT.Net” sh.p.k, NIPT L92606403F, pasi:

- ✚ Vlera e fondit limit për këtë procedurë prokurimi është 224,000,000 (Dyqind e njëzet e katër milion) Lekë pa TVSH. Operatori ekonomik IT.Net sh.p.k ka paraqitur formular oferte me vlerë 225,984,600 Lekë pa TVSH, ofertë mbi fondin limit të procedurës.
- ✚ Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas shtojcë 1.
- ✚ Nuk plotëson vlerën e xhiros vjetore të kërkuar në pikën 2.2.1 kapaciteti ekonomik dhe financiar.
- ✚ Nuk plotëson pikën 2.2.2 kapaciteti ekonomik dhe financiar në DT, pasi nuk ka paraqitur kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2019, 2020, 2021, kërkesë e kriterëve për kualifikim.
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.1 kapaciteti teknik në DT, pasi nuk ka paraqitur dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, kërkesë e kriterëve për kualifikim.
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.2 kapaciteti teknik në DT, pasi nuk ka paraqitur çertifikatat e kërkuara, kërkesë e kriterëve për kualifikim.
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.3 kapaciteti teknik në DT, pasi nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, kërkesë e kriterëve për kualifikim
- ✚ Nuk plotëson pikën 2.3.4 kapaciteti teknik në DT pasi në Shtojca 8 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” pasi nuk ka të pasqyruar punonjësit e kërkuar sipas këtij kriteri.
- ✚ Nuk plotëson pikën 2.3.5 kapaciteti teknik në DT pasi në Shtojca 8 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” pasi nuk ka të pasqyruar punonjësit e kërkuar sipas këtij kriteri.

## 3- Operatori Ekonomik “INFOSOFT SYSTEMS” sh.p.k NIPT J61820021C pasi:

- ✚ Nuk plotëson pikën 2.3.4 kapaciteti teknik në DT pasi në Shtojca 8 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, nuk ka vetëdeklaruar se ka të punësuar inxhinierin elektrik të kërkuar sipas këtij kriteri.
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.3 kapaciteti teknik në DT, pasi nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, kërkesë e kriterëve për kualifikim.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatorëve ekonomik “Iliriada” sh.p.k, NIPT J61828125L, & “Divitech” sh.p.k, NIPT L013060490, me adresë: Tiranë, Rruga Sali Butka, pallati TBM Construction, Shkalla 2, Kati 3, Ap.11, se oferta e paraqitur me

vlerë totale prej 223,500,000 (Dyqind e njëzet e tre milionë e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Ergys Verdho**